



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **29.01.2019** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni ti përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, Nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtorët e Drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Osman Ismajli, Përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSB-së, FSK-së, KFORIT, UNMIKUT, OSBES, përfaqësuesit e klerit fetar, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i parë për vitin 2019 i KKSB-së. Propozoj këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019,
2. Informim rreth gjendjes së sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit,
 - Analiza e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak,
 - Siguria në Trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e Planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit.
 - (KONKLUZAT).
3. Të ndryshme.

Kryetari - E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.

Sa për dijeni tuaj ne kemi diskutuar edhe në takimin e fundit jemi akorduar në zyrën e kuvendit të komunës përkatësisht Skender Hamza, nëse keni për të shtuar plane, veprime për vitin 2019 mund të dërgoni komente me shkrim apo ne mënyrë të drejtpërdrejtë që plani në këtë vit të jetë adekuat me nevoja, kërkesa dhe objektiva që ka komuna e Rahovecit për planin e sigurisë së përgjithshme nëpërmjet KKSB-së. Të ju them të drejtën nuk ka ardhur asnjë letër, kërkesë nga këshilli i KKSB-së, përveç Lulzim Krasniqi që ne e vlerësojmë propozimin e tij. Planet i kemi hartuar me kujdes, i kemi marrë parasysh rrethana, situata dhe i kemi harmonizuar në mënyrë që plani të jetë përputhshëm me objektiva dhe synimet që i ka KKSB-ja për këtë vit. Kemi marrë parasysh edhe propozimet për në

mars dhe nëntor, është një ide e përfaqësuesve të OSBE-së që e vlerësojmë në kuadër të planit të veprimit të kemi edhe një detyrë të dy dëgjimeve publike me qytetarët gjegjësisht me përfaqësuesit e lagjeve urbane dhe rurale të Komunës së Rahovecit, pra kryetar të këshillit të fshatrave, kryetar të këshillit të lagjeve të qytetit në mënyrë që ti dëgjojmë kërkesat, shqetësime dhe nevojat që ka komuniteti dhe ti artikulojmë në planin e punës tonë për vitin 2019-2020. Siç e kemi përcaktuar një ide të OSBE-së që të sensibilizojmë qytetarët e komunës sonë për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit me vlera që përfaqëson ose reflekton komuna jonë, vlerat ndëretnike, ndërkulturore, ndër fetare me qëllim që rritet përkushtimi ynë i përbashkët që siguria e përgjithshme në komunën tonë të kor suksese në pikëpamjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë. Jo që situata është jo stabile, por duke promovuar fushata që i imponojnë një klimë më të mirë të bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve me vlera që i kanë atëherë sigurisht do të ndikoj në sigurinë e përgjithshme. Planet e veprimit i keni të gjithë para vete, prandaj unë e hap diskutimin për ndonjë vërejtje, koment, ide, propozim që mund të pasuroj planin për këtë vit. Shkresat e dërguara me shkrim i kemi inkomporuar, ata që nuk kanë dërguar mund të dërgojnë edhe në formë elektronike, por duhet të jenë të shprehura dhe inkomporues. Njëra nga këto çështje të bëjë

diçka sa i përket këtij plani, e qes në votim Me dy propozime të OSBE-së që do të përtshihen në kuadër të këtij plani, **Planin e Veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019:** Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informim rreth gjendjes së sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit.

Osman Ismajli – Përsëritet për të gjithë të pranishmit në sallë, të nderuar të pranishëm viti 2018 kaloi shpejt por nuk ka ishte vit pa sfida, sakrifica për pushtetin lokal dhe për atë qendror mirëpo edhe për policinë e Kosovës. Unë do të ju njoftoj në pikat e shkurtra. Statistikat e shkurtra ju prezantojmë, viti 2018 ka pasur një gjendje të qetë të sigurisë në komunën tonë mirëpo edhe me gjerë në veçanti në regionin e Gjakovës, për fat kemi pasur grevë, prishje të rendit, protesta duhet cekur vërshime gjatë muajve të verës, nuk kishte dëme tek njerëz por kishte dëme të mëdha materiale në agrikulture, amvisëri dhe infrastrukturë, komisione kanë punuar në nivel komunal kanë dal raporte dhe vazhdojnë proceduarat në nivelin qendror nëse do ti mbështesin njerëz të dëmtuar apo jo. Për muajin janar statistikën nuk do ti cekim pasi që është vetëm një rast në Ratkoc eksplodimi i bombolës janë lënduar tre njerëz, bombola ishte jo e sigurt e pa kontrolluar e mbushur me njerëz, 11 ishin të lënduar, 4 ishin në gjendje të rënd të shkaillës së dytë. Në këtë muaj gjendja e krijimit është e vlerësuar me janarin e vitit të kaluar gjendja është në nivel më të mirë dhe ka një rrënjë të dukshme. Raporti për 12 muaj të vitit të kaluar 1 janar – 31 dhjetor 2018. Stacioni i policisë në Rahovec funksionon në kuadër të drejtorisë rajonale në Gjakovë regjion i cili është formuar në vitin 2015. Ky njësit funksionon vetëm me 66 punonjës prej tyre staf i uni formuar janë 55 dhe të tjerë staf civil janë 11 krahasuar me vitin 2017 kemi 7% rrënjë të stafit gjithsej, numri i cili nuk mjafton në përmbushjen e detyrave operacionale të cilat përfshihen në planin e punës dhe të obligimeve tjera. Struktura etnike e stafit është e pandryshuar d.m.th 65 janë shqiptarë dhe 1 serb. Struktura gjinore është e keqe 64 meshkuj dhe 2 femra shpresojmë që në të ardhmen të ndryshoj pasi që në shkollë janë regjistruar 130 femra në këtë gjeneratë dhe shpresoj se do të rritet % tek ne. Gjatë vitit që lamë pas edhe ky stacion është përballuar me sfidat e ndryshme gjatë përmbushjes së realizimit të objektivave të ndryshme të parapara gjatë vitit 2018, edhe më tej mungesa e stafit, e pajisjeve logjistike paraqet problem në përmbushjen e detyrave, gjendja e pajisjeve me vetura nuk është e mirë, është blerë një numër i vogël i veturave gjatë këtyre viteve, gjithashtu gjendja e punëtorëve nëpërmjet sindikatave ka pakënaqësi me qëllim të përmirësimit të tyre, si çështja niveli i pagave të punës, mos pagesa e orëve shtesë, pa sigurim shëndetësor, duke ju nënshtruar permanenteve të rreziqeve gjatë kryerjes së detyrës, mos pagesa e shujtës etj. Pavarësisht këtyre problemeve njësit ynë ka arritur ti përmbush të gjitha objektiva dhe përgjegjësit gjatë vitit 2018. Prishja dhe qetësia e rendit të ditës gjatë vitit 2017 ishin 27 raste, gjatë vitit 2018 ishin 23 raste, rrënjë për 18%. Greva ishin gjithsej 5, në arsim 3 dhe 2 në shëndetësi. Protesta ishin gjithsej 3 njëra nga tifozët dhe 2 nga rrjeti i grave. Tek kriminaliteti kemi pasur një rritje 8% në 2018 krahasuar me 2017. Zbulueshmëria e rasteve në vitin 2017 ishte 70% ndërsa në vitin 2018 56%. Totali i raportuar i rasteve të hapura në vitin 2017 ishte 517 ndërsa në 2018 ishte 524 në rrënjë 1% të rasteve. Tek

incidente kemi pasur 3 vetëvrasje në vitin 2017 ndërsa 4 në vitin 2018. Tentim vetëvrasje 37 raste në 2017, ndërsa në vitin 2018 kemi pasur 9 raste. Vepra të rënda, 1 vrasje në vitin 2017, në vitin 2018 nuk kemi. Lëndime të rënda trupore në vitin 2017 ishin 5, ndërsa në vitin 2018 kemi 7 raste, lëndime të lehta në vitin 2017 ishin 64, ndërsa në vitin 2018 ishin 66 raste, vjedhjet në vitin 2017 ishin 47 raste, në vitin 2018 ishin 35 raste, kishte rrënje për 12%, vjedhje të rënda në 2017 janë 84 raste, ndërsa në vitin 2018 janë 95 raste kemi rritje, totali tek vjedhje kemi 12% rrënje, tek grabitje kemi pasur 2 raste në vitin 2017, në vitin 2018 në rast, dhe një tentim grabitje në ETC në fund vit. Në konfiskimin e armeve në vitin 2017 kishim 17 raste dhe 90 municione, në vitin 2018 janë konfiskuar 27 armë dhe 292 municione, kemi 53% rritje krahasuar me vitin 2017. Raste ku minoritetet paraqiten si viktimë janë gjithsej 26 raste, 23 raste janë mbyllur dhe 3 raste kanë mbetur nën hetime, kemi të bëjmë me prishje të rendit, vjedhje, dëmtim prone, fyerje, kërcënime. Sa i përket vizitave të pelegrinëve të objekteve të TFK-së ishin 37 të organizuara më përcjellje për afërsisht 3200 vizitorë, duke marrë parasysh ky numër dyfishohet nga vizita individuale apo grupe të vogla me vetura, si vizita familjare etj, nuk ka pasur

Incidente në familje në vitin 2017 ishin 20 raste, në vitin 2018 kemi 30 raste kemi në rritje për 30%, përndryshe është vetëdijesimi i fëmijëve, pleqve, temrave nga mos tolerimi i rasteve të dhunës në familje. Incidente në shkollë në vitin 2017 janë 8 raste, në vitin 2018 janë 10 raste kemi të bëjmë me lëndime trupore dhe konfrontime verbale si dhe dëme materiale të cilat shkaktohen nga nxënësit. Çdo vit janë implementuar 9 projekte nëpër shollë janë përfshi 3600 nxënës në 11 shkollë tema ishin dhuna në familje dhe siguria në internet, siguria e përgjithshme, policia në bashkësi dhe roli i saj si dhe delikuenca e të miturve, dhuna, duhani, droga dhe projekti i rrjeteve sociale, komunikacioni rrugor, të gjitha kategoritë e rrugëve në komunën tonë ka qenë e mirë por për fat të keq ende nuk është në nivel vetëdijesimi dhe edukata e pjesëmarrësve në trafik kështu që ka një rrënje tek aksidentet, mirëpo shkak është tejkalimi i shpejtësisë, përdorimi i telefonit, konsumimi i alkoolit, infrastruktura rrugore e shkartuar nga qytetar. Rregullimi rrugor të trafikut në komunën tonë e bën trafiku rajonal i Gjakovës dhe njësite të këtij stacioni. Aksidente në trafik janë në rrënje për fat të mirë kemi pasur vetëm një aksident me fatalitet vetëm një person ka vdekur në Mrasor në magjistralen Gjakovë-Prishtinë, ndërsa në vitin paraprak ishin 5 viktima të vdekur në aksidente, në komunën tonë janë regjistruar gjithsej 226 aksidente trafiku. Stacioni policor ka trajtuar 88 raste, trafiku rajonal 141. Në vitin 2018 janë lëshuar gjithsej 11,325 gjoba prej këtyre sipas statistikave që i kemi në nga banka diku rreth 70% janë paguar duke marrë parasysh motivacionin që të paguajnë vetëm 50% të dënimit, shikojmë më vonë raportin nga financa se sa janë derdhur paratë në fond. Trafiku rajonal ka lëshuar 5972 gjoba, kurse njësitë të këtij stacioni 5353, aktivitete tjera janë realizuar 500 urdhër dhe urdhëresa nga gjykata dhe prokuroria e shtetit, janë dhënë asistime gjithsej 177 inspektoratit, KEDS-it, Radoniqit, ekonomisë së pyjeve, aktivitete sportive përmbaues privat. Rastin e vërshimeve e ceka kemi pasur 2 raste, e kemi një statistikë e cila është mjaftë e keqe kemi të bëjmë me lëshimin e dokumentacionit SIK të ne, janë lëshuar vërtetime për të kaluarën kriminale 3100 mbi 95% kanë të bëjnë me viza janë larguar nga Kosova qoftë me viza pune, bashkim familjar, apo qoftë mënyra tjera, është me të vërtetë shifër shqetësuese këto 3 vite të fundit është në rritje 50% 2016-2017 është 50 %, 2017-2018 është 50%. Kemi 5 raste tek disiplina kryesisht kemi të bëjmë me ankesa të qytetarëve të pa bazuara, ndërsa 2 raste të tjera një është i dënuar zyrtar ishte i suspenduar 48 orë dhe një rast është i pa mbyllur nën hetime. Menagjimenti i stacionit në Rahovec ju bën ftesë të gjithë qytetarëve të komunës pa dallim organeve të pushtetit lokal, institucione të tjera shtetërore dhe publike, bizneseve, shkollave, OJQ-ve, mediave, Ushtrisë së Kosovës, institucione ndërkombëtare, KFOR-it, OSBE-së, UNMIK-ut, që ta ngritin bashkëpunimin dhe partneritetin me policinë e Kosovës në parandalimin dhe luftimin e çdo dukurie negative në shoqëri dhe ngritjes së nivelit të qetë në komunën e Rahovecit.

Kryetari - Duke e vlerësuar kontributin real që dha komandanti i stacionit të policisë Osman Ismajli nëpërmjet shifrave konkluzion i këtij takimi të parë që besoj na jep obligime, detyra, në përditshmëri mua si kryetar i komunës dhe stacionit të policisë dhe të gjithë anëtarëve të komunës në përgjithësi të mobilizohemi shumë më shumë që ta ulim kriminalitetin ose ti ndërmarrim masa në përputhje me përgjegjësit që i kemi, policia kryen punën e vet, anëtar të KKS-së bëjnë angazhimin e vet, komuna i ka detyrat e veta që ti parandalojmë me masa tona ta ulim nivelin e kriminalitetit në komunën tonë, te

rrisim sigurinë në trafik, shkolla pra të kemi masa dhe veprime më efikase që të ndikojmë stabiliteti i përgjithshëm e sigurisë në komunë të rritet çdo ditë e më shumë. Unë ju mirëkuptoj edhe në cilësinë e kryetarit të komunës dhe shqetësimet e stacionit policor por ju inkurajoj secilin prej jush që të punojmë shumë më shumë dhe ti realizojmë objektivat tona duke aplikuar masa dhe praktika sa më të mira që KKSB-ja të kryen si institucion rolin e vetë, të reflektoj suksesin që e ka për detyrë, po ashtu edhe institucione komunale të japin më shumë kuptim dhe të pasurojnë sfondin e angazhimeve që siguria e përgjithshme në komunë të mbahet më stabile dhe të jetë më e qëndrueshme në vitin 2019. Ne kemi një varg aktivitete që do ti zhvillojmë edhe si komunë, natyrisht secili institucion në kuadër të detyrës dhe përgjegjësisë që ka, edhe policia dhe inspektorati, shërbime publike, bashkësi fetare, përfaqësues të minoriteteve, përfaqësues të biznesit, përfaqësues për mbrojtje dhe shpëtim të gjithë së bashku secili ti kryej detyrat e veta besoj ky vit do të jetë më i suksesshëm. Gjithashtu neve na takon të punojmë që mos ti kemi shifra alarmante të largimit të të rinjve nga republika e Kosovës. Në kuadër të përpjekjeve që i kemi do të takohemi përsëri në takimin tonë të ardhshëm do të shikojmë bilancin pozitiv të punës dhe të flasim më shumë për arritje tona më shumë në planin dhe veprimin e KKSR-së i cili është miratuar nga ana juaj, inkurajoj bashkëpunimin dhe ndërmarrjen e masave të kryejme funksionin tonë dhe të reflektojmë se ky institucion është i dobishëm dhe jashtëzakonisht do të jetë i suksesshëm në realizimin e synimeve, objektivave dhe prioritetëve në agjendën dhe detyrave që i ka çdo muaj. Kalojmë në pikën e radhës:


3. Të Ndryshme.

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e deklaroj të mbyllur këtë takim shihemi në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20

Procesmbajtësi

Skendr Hamza



Kryetar i Komunës

Smajl Latifi